



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1651/11 prot.

Datë 23.06.2026

V E N D I M
Nr. 854/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.06.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.780/2026, datë 10.06.2026, për procedurën e prokurimit “*Procedure e hapur e thjeshtuar-MALL*”, me Nr. REF-82816-04-21-2026, me objekt “*BLERJE MATERIALE SINJALISTIKE*”, me fond limit 7 498 060 (shtatë million e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë.

Ankimues:

OE “R. S. & M” Shpk me NUIS K32203002I, me adresë: Tiranë, AUTOSTRAD KM 2,.

Autoriteti Kontraktor:

Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë, me adresë: Lagjja, “Kushtrimi”, ish Parku i Autobusave, Vlorë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 10.06.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.780/2026, ku vendosi:

1. Të pranojë pjesërisht, ankesën e operatorit ekonomik “R. S. & M” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar-MALL”, me Nr. REF-82816-04-21-2026, me objekt “BLERJE MATERIALE SINJALISTIKE”, me fond limit 7 498 060 (shtatë million e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi për operatorin ekonomik “R. S. & M” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë ofertues.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “R. S. & M” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

1.2. Me shkresën nr. 460/33 prot., datë 16.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1651/8 prot., datë 19.06.2026 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 780/2026, datë 10.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar-MALL”, me Nr. REF-82816-04-21-2026, me objekt “BLERJE MATERIALE SINJALISTIKE”, me fond limit 7 498 060 (shtatë million e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë.

-bashkëlidhur ka dërguar edhe procesverbalin e rivlerësimit me nr. 460/32 prot., datë 15.06.2026 (vendimi KVO), nënshkruar nga anëtarët e KVO-së;

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 460/33 prot., datë 16.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1651/8 prot., datë 19.06.2026 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 780/2026, datë 10.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar-MALL”, me Nr. REF-82816-04-21-2026, me objekt “BLERJE MATERIALE SINJALISTIKE”, me fond limit 7 498 060 (shtatë million e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë.

-bashkëlidhur ka dërguar edhe procesverbalin e rivlerësimit me nr. 460/32 prot., datë 15.06.2026 (vendimi KVO), nënshkruar nga anëtarët e KVO-së;

II.2. Nga verifikimi i procedurës në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe informacionit të sipërcituar, të dërguar me shërbim postar nga autoriteti kontraktor, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka rivlerësuar ofertën e operatorit ekonomik “R. S. & M” SHPK, sipas konstatimeve të shprehura, në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.780/2026, datë 10.06.2026, sipas së cilit, ka rivlerësuar arsyet e skualifikimit për operatorin ekonomik ankimues “R. S. & M” shpk.

Gjithashtu, bashkëlidhur informacionit, ka dërguar edhe procesverbalin e rivlerësimit me nr. 460/32 prot., datë 15.06.2026 (vendimi KVO), nënshkruar nga anëtarët e KVO-së.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedure e hapur e thjeshtuar-MALL*”, me Nr. REF-82816-04-21-2026, me objekt “*BLERJE MATERIALE SINJALISTIKE*”, me fond limit 7 498 060 (shtatë million e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

